



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 39 datë 26 . 03 .2026

**PËR MIRATIMIN E DORËHEQJES**

**TË ANËTARIT TË KËSHILLIT Z.ERJON NEXHIPI**

Këshilli i bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të sotme pasi mori në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të këshilltarit z.Erjon Nexhipi me nr.8520 prot.datë 17.03.2026, në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”,i ndryshuar , gërma (b) e pikës 4 të nenit 49 si dhe gërma (j) e nenit 54, si dhe në zbatim dhe të gërmës (c) të pikës 1 të nenit 15, të Rregullores së Këshillit Bashkiak Korçë, miratuar me Vendimin nr 80 datë 30.07.2020” Për miratimin e Rregullores të Këshillit Bashkiak Korçë”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dorëheqjen e këshilltarit të Këshillit të Bashkisë Korçë z.**Erjon Nexhipi** dhe deklarimin e mbarimit të mandatit përpara afatit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimin e procedurave me K.Q.Z-në ngarkohet sekretari i këshillit të Bashkisë Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 26-03-2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

Korçë, më 17 Mars 2026

*Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Korçë*

*Për dijëni: Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Korçë*

*Për dijëni: Sekretarit të Këshillit të Bashkisë Korçë*

**Lënda: Dorëheqje nga mandati i këshilltarit të Këshillit të Bashkisë Korçë**

Unë, Erjon Nexhipi, anëtar i Këshillit të Bashkisë Korçë, i zgjedhur në listën e Partisë Socialiste, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si edhe të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak Korçë, paraqes me këtë shkresë dorëheqjen time nga mandati i këshilltarit të Këshillit të Bashkisë Korçë.

Kjo dorëheqje paraqitet për shkak të pamundësisë për të vazhduar ushtrimin e këtij mandati, si pasojë e disa angazhimeve familjare që nuk më lejojnë të vijoj me përkushtimin dhe kohën e nevojshme për përmbushjen e rregullt të detyrës.

Për sa më sipër, ju lutem të merrni në shqyrtim këtë dorëheqje dhe të ndiqni procedurën përkatëse ligjore për deklarimin e mbarimit të mandatit tim, sipas legjislacionit në fuqi.

Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Me respekt,  
Erjon Nexhipi

